- Mangësitë e përpilimit dhe detajizimit të kriterëve dhe precizimi i detajeve teknike shpesh reflektohen gjatë kontrollit në terren dhe në procesin e hartimit të raporteve nga Kontrolli në terren i cili bie ndesh me projektin e miratuar. Këtu duhet vënë në pah edhe gabimet e shumta teknike gjatë vlerësimit të tyre, mungesat në dokumentacion (që shpesh ndodh të mos dorozohet dokumentacioni komplet, që nga zyrtarët komunal e deri tek zyrtarët e vlerësimit;
- Duhet pasur parasysh edhe ndryshimet në Masat e reja që janë aplikuar këtë vit për të cilat ne nuk kemi pasur përgatitjet e duhura as teorike e as në mjete teknike (Masa 103 dhe Masa Ujitja) dhe shpesh na është dashur të improvizojmë (Matja e thellësisë së puseve, trashësisë së gypave dhe rezervuarëve të ujit, etj.) dhe kjo paraqet një vështërsi në procesin e kontrollit;
- Mungesa e udhëzuesve apo doracakëve, si: shtojca të programit për standardet teknike të ndërtimit të shtallave, serrave pemishteve, etj;
- Mungesa e digjitalizimit të parcelës (lokalitetit) ku do të realizohet investimi;
- Presionet e ndryshme dhe kërcnimet e inspektorëve gjatë kontrollit në terren;
- Numri i madh i lëndëve për kontrollë, pasi që inspektorët e angazhuar në kontrollin e PZHR-ve janë shumë të angazhuar edhe në kontrollin e pagesave direkte;
- Mungesa e ndarjes dhe e profilizimit të inspektorëve për kontrollin e PD dhe kontrollin e Masave të ZHR;
- Motivimi i ulët për punë i inspektorëve në pamundësi të kompenzimit të rrezikshmërisë dhe pagesave për punë jashtë orarit të punës dhe vikendeve;



- Mbështetja e dobët logjistike për kryerjen e aktiviteteve të kontrollit (veturat e amortizuara, vonesat në servisim dhe cilësia e ulët e servisimit të automjeteve);
- Vonesat në aplikim;
- Digjitalizimet e gabuara;
- Humbjet e kohës së kontrollit me aplikantë të pandërgjegjshëm që refuzojnë nënshkrimin e Raportit të kontrollit dhe që nuk dalin në vendngjarje për përfundimin e kontrollit;
- Pengesat nga ana e aplikantëve në punën e inspektorit - Pengesa e personit zyrtar në kryerjen e detyrës;
- Mostra e madhe për kontrollë, etj.



DIVIZIONI I IT & REGJISTRAVE

Në Divizionin e Teknologjisë Informative dhe Regjistrave gjenden të gjithë regjistrat e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, si: Regjistri Elektronik i Fermerve (eFR), Sistemi i Identifikimit të Parcelave të Tokës (LPIS), LPIS-Mobile i cili përdoret për kontrollë në terren për sipërfaqe, Softueri për Menaxhimin e Pagesave i cili përfshin modulën për aplikim për grante dhe kërkesën për pagesë të granteve, menaxhimin e granteve, autorizimin e pagesave të granteve, menaxhimin e pagesave direkte, softueri për indikator, ueb faqja e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë.

Divizioni i Teknologjisë Informative dhe Regjistrave bënë mirëmbajtjen e të gjithë kompjuterëve të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë duke përfshirë edhe Zyrët Regjionale, nga Divizioni i Teknologjisë Informative dhe Regjistrave bëhet kërkesa në Ministrinë e Administratës Publike për hapjen e llogarive zyrtare (emaili zyrtar) dhe vazhdimin e tyre për qasjen në dokumentin shtetëror. Të gjithë zyrtarët e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë janë të qasur në server (share folder) për ruajtjen direkte të të dhënave në server. Nga Divizioni i Teknologjisë Informative dhe Regjistrave bëhet ruajtja (backup) i të gjitha të dhënave që janë të ruajtura në server (share folder), ruajtja (backup) e të dhënave për Softuerin për Menaxhimin e Granteve (në këtë softuer përfshihet menaxhimi i granteve, moduli i aplikimit për grante dhe plotësimi i kërkesës për pagesë në zyrët regjionale të AZHB-së, autorizimi i pagesave të granteve dhe pagesat direkte), gjithashtu edhe ruajtja (backup) e të dhënave të serverit, ku është i instaluar Regjistri Elektronik i Fermerve (eFR) dhe Sistemi i Identifikimit të Parcelave të Tokës (LPIS).




Figura 27. Lidhja e regjistrave të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë



Në këtë skemë mund të shihet Sistemi i Komunikimit të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë-AZHB-së, Data bazat e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB), si dhe komunikimi i rrjetit të internetit në mes të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB) dhe Ministrisë së Administratës Publike, përkatësisht Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit (ASHI):




Figura 28. Sistemi i komunikimit i AZHB-së



Regjistri Elektronik i Fermerëve (eFR)

do të thotë listë e kompjuterizuar e të dhënave të hartuara nga ana e institucionit përkatës brenda Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (MBPZHR-AZHB) me qëllim të identifikimit të fermerëve që mund të përfitojnë nga mbështetja financiare nga autoritetet kombëtare dhe/ose burime të tjera, si dhe fermerët të cilët dëshirojnë të regjistrohen në bazë vullnetare.

Regjistri elektronik i fermerëve (eFR), Databaza e eFR-së është e instaluar në server të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB), ku serveri është i hostuar në dhomën e servereve të Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit (ASHI) në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike ku gjatë gjithë kohës është funksional. Regjistrimi i fermerëve bëhet në zyrët komunale në Drejtoratet e Bujqësisë dhe në Zyrët Regjionale të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB). Krijimi i përdoruesve dhe administrimi i këtij regjistri bëhet nga Drejtorati i Regjistrave varësisht sipas pozitës së zyrtarit që duhet të ju krijohet përdorimi.

Regjistrimi i fermerëve është i rregulluar me “Udhëzim Administrativ Nr.07/2011 për regjistrin e fermerëve” regjistrimi është vullnetar, obligativ është vetëm për fermerët që aplikojnë për grante dhe subvencione. Regjistri Elektronik i Fermerëve (eFR) ka filluar të funksionoj në vitin 2012 dhe gjatë këtij viti janë regjistruar 16,608 fermerë, ndërsa në vitin 2013 kanë qenë të regjistruar 26,603 fermerë, kurse në fund të vitit 2014, përkatësisht me 31.12.2014 numri i fermerëve të regjistruar ka arritur në 34,775 fermerë në 37 komuna të Kosovës.

Gjatë gjithë vitit u është dhënë mbështetje direkte zyrtarëve komunal dhe zyrtarëve regional të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB) për regjistrimin e fermerëve në Regjistrin Elektronik të Fermerëve (eFR).




Tabela 46. Numri i Fermerëve të regjistruar nëpër vite 2012-2014

Në Regjistrin Elektronik të Fermëve (eFR) përfshihen të dhënat për fermerin, tokën në shfrytëzim, të dhënat për kafshë, mekanizmi bujqësor si dhe nënshkrimi i fermerit.

Për fermerin i kemi të dhënat për emrin, mbiemrin, emrin e babës, datëlindjen, numrin personal, gjuhën e fermerit, komunën, vëndbanimin, telefonin, e-mailin, koordinatat e fermës që mirren nga Sistemi i Thjeshtësuar i Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS) emri i bankës dhe numri i xhirollogarisë, etj.

Për tokën në shfrytëzim i kemi të dhënat për tokën e punëshme, si: ara, kopshte, lëndinë e përhershme, pemishte, vreshta, pyje, të dhënat plotësohen për sipërfaqen e tokës në pronë në hektar dhe sipërfaqën e tokës në huazim me qëra, patate mbi 10 (dhjetë) hektarë, drithëra mbi 50 (pesëdhjetë) hektarë, bimë industriale, hortikulturë e hapur mbi 3 (tre) hektarë, hortikulturë e mbuluar mbi 0.30 (zero pikë tridhjetë) hektarë.

Për kafshë i kemi të dhënat për lopë qumështore, mëshqerra (mbi dy vite), dema (mbi dy vite), një deri në dy vite meshkuj, një deri në dy vite femra, dele për mbarështim, dele (desh, qingja, rrunza), dhi për mbarështim, dhi (cjep, keca, ftuja), derra nën 20 (njëzet) kg, dosat për mbarështim mbi 50 (pesëdhjetë) kg, derra tjerë, kuaj, gomarë, pula, zogj, bletë, etj.

Për mekanizëm i kemi të dhënat për traktorë, motokultivatorë dhe autokombanja dhe është pjesa e nënshkrimit, ku në këtë pjesë përfshihen të dhënat për datën e regjistrimit dhe vendin e regjistrimit. Pas regjistrimit të fermerit gjenerohet NIF, “NIF” do të thotë Numri Identifikues i Fermës.



Pasi të bëhet gjenerimi i NIF-it është e mundur shtypja e çertifikatës së fermerit dhe aneksit me të dhënat e fermerit, ku në aneksin e eFR-së e nënshkruan zyrtari përgjegjës gjatë regjistrimit dhe fermeri.

Regjistri Elektronik i Fermerve (eFR) është i lidhur me Sistemin e Thjeshtësuar të Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS) ku nuk mund të kalohet në sLPIS pa qenë i regjistruar në eFR.




Figura 29. Procesi i regjistrimit të fermerit në eFR:



Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Regjistri elektronik i fermerëve

HYRJE EFR STATISTIKAT HISTORIZIMI ADMINISTRIMI

Çkyçu

Kërko Fermeri Toka në shfrytëzim Kafshët Mekanizimi Nënshkrimi

NIF Nr. personal Kërkimi i detajuar

Kërkim automatik Statusi

Emri Mbiemri

Emri babës Pages per kafshë

Kompania Nr. regj. Kompanisë

Komuna Vendbanimi/Fshati

Fermeri i ri Pastro fushat Kërko

Rezultatet (Nr. total i fermerëve: 34782)

	Statusi	NIF	Nr. personal	Emri	Mbiemri	Emri babë	Komuna	Vendbanimi/Fsh	Kompania
+	■	1000007	100000000	Prishtinë	Keçekollë	
+	■	1000002	100000004	Prishtinë	Prishtinë	
+	■	1000005	100000003	Prishtinë	Keçekollë	
+	■	1000006	100000000	Prishtinë	Dabishec	
+	■	1000003	100000007	Prishtinë	Prapashticë	
+	■	1000005	100000003	Prishtinë	Dabishec	
+	■	1000006	100000003	Prishtinë	Prishtinë	
+	■	1000000	100000000	Prishtinë	Prapashticë	
+	■	1000003	100000003	Prishtinë	Prishtinë	

Faqe 1 nga 51 20 Listo 1 - 20 nga 1 019

HYRJE EFR STATISTIKAT ADMINISTRIMI HISTORIZIMI RRETH NESH KONTAKTI

Created by EU FARM Project

Figura 30. Regjisti Elektronik të Fermerve (eFR) i cili është Ueb aplikacion dhe funksionon në tri gjuhë: shqip, anglisht dhe serbisht



Në eFR është forma e aplikimit për Pagesa Direkte ku është bërë hapja e kampanjës për aplikim nga Divizioni i TI dhe Regjistrave dhe është bërë trajnimi i zyrtarve komunal për përdorimin e eFR-së, ku gjatë gjithë kohës së aplikimit zyrtarët komunal janë mbështetur direkt për përdorimin më të lehtë të formës së aplikimit ku është bërë aplikimi për lopë qumështore, bletë, dele, dhi.

Animal Subvention

Fermeri: test test NIF: 1016395

⚠ Aktualisht nuk ka kampanjë të hapur

I. Dokumentet e bashkëngjitura

1. Kopja e letërnjoftimit	<input type="checkbox"/>	2. Kopja e llogarisë së vlefshme bankare	<input type="checkbox"/>
3. Regjistrin e lëshuar nga AUV	<input type="checkbox"/>	4. Çertifikata që dëshmon pagesën e tatimit në pronë	<input type="checkbox"/>
5. Deklarata e aplikuesit	<input type="checkbox"/>	6. Kopje e aplikacionit	<input type="checkbox"/>
7. Aplikacioni është komplet	<input type="checkbox"/>		
8. Komente	<input type="text"/>		

Pagesa për kafshët

Numri i aplikacionit		Data e aplikimit	22.12.2014
Numri i regjistrit të fermës për lopë	<input type="text"/>	Numri i regjistrit të fermës për dele dhe dhi	<input type="text"/>
Numri i krerëve të lopëve qumështore	<input type="text"/>	Numri i krerëve të deleve	<input type="text"/>
Numri i krerëve të dhive	<input type="text"/>	Numri i shoqërive të bletëve	<input type="text"/>
Vendi i aplikimit	<input type="text"/>	Data e nënshkrimit	<input type="text"/>

Mbylle

Figura 31. Regjistri Elektronik të Fermerëve (eFR) i cili përdoret për aplikim online për Pagesa Direkte për kafshë



Sistemi i Identifikimit të Parcelave të Tokës (LPIS)

Përmes këtij sistemi është bërë aplikimi për 27 kultura bujqësore në vitin 2014, gjatë viteve paraprake është bërë aplikimi vetëm për 3 kultura bujqësore: për grurë, misër dhe luledielli, ndërsa në këtë vite me vendim të Ministrit janë shtuar edhe 24 kultura bujqësore që në këtë vit, pra në vitin 2014 është bërë aplikimi për 27 kultura bujqësore e ato janë: grurë, farë gruri, misër, luledielli dhe për perime në fushë të hapur (lakër, lulëlakër, spinaq, presh, qepë, hudhër, panxhar, karrota, domate, patëllxhan, tranguj, patate, shalqinj, pjepër, kungull gjelle i gjelbër (kungulleshë), kunguj misri, fasule, bizele, kunguj, speci, marulla, magdanoz dhe rrepa). Pas hapjes së kampanjës janë trajnuar zyrtarët komunal për digjitalizimin e parcelave dhe u është dhënë mbështetje direkte gjatë digjitalizimit të parcelave gjatë kohës së aplikimit të fermerëve për mbështetje direkte për sipërfaqe. Gjatë vitit 2014 është bërë instalimi i ortofotove të reja të vitit 2012 dhe është bërë i mundshëm krahasimi i ortofotove të vitit 2009 dhe 2012 ku mund të shfaqen ortofotot dhe mund të bëhet krahasimi i tyre. Po ashtu është bërë edhe lidhja e Sistemit të Identifikimit të Parcelave të Tokës (LPIS) me Agjencinë Kadastrale të Kosovës përmes Geoportalit ku jemi duke i shfrytëzuar të dhënat për zonat kadastrale, kadastrin e parcelave, lumenjtë dhe hekurudhat.



Figura 32. Lidhja e LPIS-it me Agjencinë Kadastrale të Kosovës përmes Geoportalit




Figura 33. Skema e funksionimit të LPIS-it dhe LPIS-MOBILE

Aplikimi i fermerëve për mbështetje ka qenë në rritje të vazhdueshme nëpër vite. Më poshtë do t'i paraqesim aplikimet e fermerëve nëpër vite.

Gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2011/12 (kampanja për aplikim për grurë është hapur në dhjetor të vitit 2011) për mbështetje direkte për grurë kanë aplikuar 8,825 fermerë dhe janë digjitalizuar 37,891 parcela me grurë me 43,008.02 hektarë, ndërsa për misër kanë aplikuar 2,341 fermerë dhe janë digjitalizuar 5,989 parcela, me misër me 5,983.72 hektarë dhe për luledielli kanë aplikuar 32 fermerë dhe janë digjitalizuar 87 parcela me luledielli me 769.79 hektarë.

Totali i parcelave të digjitalizuara gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2011/12 është 43,967, ndërsa i hektarve 49,761.53.

Gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2012/13 (kampanja për aplikim për grurë është hapur në dhjetor të vitit 2012) për mbështetje direkte për grurë kanë aplikuar 11,728 fermerë dhe janë digjitalizuar 49,106 parcela me grurë me 53,933.52 hektarë, ndërsa për misër kanë aplikuar 3,726



fermerë dhe janë digjitalizuar 11,202 parcela me 10,233.85 hektarë dhe për luledielli kanë aplikuar 31 fermerë dhe janë digjitalizuar 73 parcela me 487.12 hektarë.

Totali i parcelave të digjitalizuara gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2012/13 është 60,381, ndërsa i hektarve 64,654.49.

Gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2014 për mbështetje direkte për grurë kanë aplikuar 11,781 fermerë dhe janë digjitalizuar 50,168 parcela me 52,003.32 hektarë, ndërsa për farë gruri kanë aplikuar 17 fermerë dhe janë digjitalizuar 41 parcela me 439.11 hektarë, për misër kanë aplikuar 6,084 fermerë dhe janë digjitalizuar 16,726 parcela me 15,171.26 hektarë, për luledielli kanë aplikuar 14 fermerë dhe janë digjitalizuar 37 parcela me 653.69 hektarë dhe me perime në fushë të hapur kanë aplikuar 2,950 fermerë dhe janë digjitalizuar 5,770 parcela me 3,889.05 hektarë.

Totali i parcelave të digjitalizuara gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2013/14 është 72,742, ndërsa i hektareve 72,156.43.




Figura 34. Numri i fermerëve që kanë aplikuar përmes sLPIS-it, numrin e parcelave dhe sipërfaqen e digjitalizuar gjatë kampanjave për aplikim për subvencione 2011/12, 2012/13, 2014




Figura 35. Sistemin e Identifikimit të Parcelave të Tokës (LPIS)



Për kontrollë në terren, inspektorët e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë përdorën LPIS-Mobile i cili funksionon pa qasje në rrjet të internetit (offline), ku ngarkohen të dhënat nga Sistemi i Identifikimit të Parcelave të Tokës (LPIS) në LPIS-Mobile vetëm me qasje të lloptopit në rrjet qeveritar dhe bartja e të dhënave nga LPIS-Mobile në Sistemin e Identifikimit të Parcelave të Tokës (LPIS). Ngarkimi i të dhënave bëhet shumë shpejt me një komandë e cila bën transferimin e të dhënave. Konfigurimi i LPIS-Mobile në lloptop është bërë nga Divizioni i Teknologjisë Informative dhe Regjistrave, po ashtu edhe konfigurimi i GPS-ve që përdorin inspektorët në terren.




Figura 36. LPIS-Mobile i cili funksionon (offline) pa qasje në rrjet të internetit i cili përdoret nga inspektorët për kontrollë në terren



Softueri Grant Menaxhmenti

Ky softuer përmban modulën për aplikim për grante dhe kërkesën për pagesë, menaxhimin e granteve, autorizimin e pagesave dhe pagesat direkte.

Softueri për aplikim për grante dhe kërkesën për pagesë: Ky modul është instaluar në zyrat regjionale të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë - AZHB ku bëhet aplikimi sipas masave dhe nënmasave të Projekteve të Zhvillimit Rural. Ruajtja e të dhënave gjatë aplikimit bëhet në server të AZHB-së dhe gjatë gjithë kohës zyrtarët përgjegjës të menaxhimit të granteve mund të shohin të dhënat e fermerëve që kanë aplikuar sipas masave dhe nënmasave dhe shumën e projektit që ka aplikuar. Gjatë plotësimit të kërkesës për pagesë regjistrohen të gjitha fakturat që sillen nga fermeri që ka bërë kërkesë për pagesë dhe gjatë gjithë kohës zyrtarët e Autorizimit të Pagesave mund të shohin se sa fermerë kanë bërë kërkesë për pagesë.




Figura 37. Softueri për aplikim për grante dhe kërkesën për pagesë i cili funksionon në shtatë zyrat regjionale të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë – AZHB

Menaxhimi i granteve: Gjatë vitit 2014 është avancuar më tutje Softueri për Menaxhimin e Granteve ku është përgatitur për menaxhimin e granteve të vitit 2014 dhe nga ky softuer po ashtu është mundësuar edhe përpilimi i kontratave që ka nënshkruar Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë - AZHB me fermerë. Pas aplikimit në softuerin për aplikim për grante, zyrtarët e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë – AZHB fillojnë me poentimin e tyre sipas kriterëve që janë të rregulluara me udhëzimin administrativ të vitit përkatës.



Republika e Kosovës
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë

Projektit e Zhvillimit Rural të Kosovës

Administrimi Deficionet Regjistrimi Raportet Pagesat

Lista e të gjitha aplikacioneve të vlerësuar

Viti: 2013 Komuna: Te Gëtha Mëso: Rritëkrimi i potencialit tokë në sektorin Agro Rural 2013 Niveli-Mëso: Sektori i mishit- viza dhe brojer 2013

Nr Personal	Emri	Mbiemri	Telefoni	Vendbanimi	Emri i Projektit	Nr i aplikacionit	Sasia	Nj. Matëse	Vlera e projektit	Data	Ora	Pisimet	
1232130128	Edona	Berisha	044-041-088	Subashi - Gjiroca	Ndërtimi i fermës moderne për magjmet të vizar	01/24	10.00	Copë	70400.00	25.03.20	15.26	100 / 80	
2204450089	Xhelana	Haidari	044652311	Kaçanak - Elëçaj	Ferme për ritjen e brojerave	061/2013	5.00	Copë	24710.50	25.04.20	11.30	100 /	
1004470318	Ajeta	Lubishtan	044183729	Vll - Shkate e poshtme	Ndërtimi i shtalles	26/192	5.00	Copë	24710.50	25.04.20	11.45	100 /	
1234227574	Berinda	Berifaj		Gjakovë - Mamuli	Ndërtimi i shtalles s'77e për viza për magjmet		1.00	Copë	46960.00	29.04.20	12.20	100 / 80	
1002370502	Shpetim	Arifaj	044283185	latoq - litoq i Poshtem	Ndërtimi i shtalles së brojerave	06/011	5.00	Copë	29250.00	02.03.20	08.00	98 /	
1500269738	Fadi	Koca	45452211	Skenderaj - Polac	Ndërtimi i shtalles së vizarve depa dhe peshore	1	3.00	Copë	37120.00	11.03.20	10.00	98 /	
1013061587	Bujar	Tërtona	45534002	Ferizaj - Ferizaj	Ndërtimi i shtalles së vizarve për magjmet	25/041	2.00	Copë	85200.00	21.03.20	10.22	98 / 88 /	
1002260442	Agron	Çeta	044200158	latoq - Tuduhoç	Prodhimi i mishit të vizarve	06/094	12.00	Copë	114634.00	27.03.20	09.00	98 / 88 /	
1171004353	Muhadin	Berisha		Kaçanak - Runjevë	Shtalla e vizarve	38/2013	4.00	Copë	43136.00	27.03.20	15.30	98 /	
1013454163	Ishri	Sefaj	45307774	Paqe - Kozdrac	Ndërtimi i shtalles së re për trashjen e vizarve d		12.00	Copë	50900.00	28.03.20	10.00	98 /	
1172438101	arben	veku		Rahovec - Kuzha e Madhe	detimi i fermës për magjmet e vizarve	11/3/29	3.00	Copë	34617.76	29.03.20	09.00	98 /	
1500530339	Bujar	Avdyli		Sheqerç - Kashtarjeve	Ndërtimi i shtalles dhe opërketeve përçelës	23/	17.00	Copë	57100.00	15.04.20	13.05	98 / 72 /	
1013614004	arben	berisha	044/185/075	Podujevë - Dobërdol	Ngritja e shtalles për viza dhe pajisje	18/151	3.00	Copë	50135.00	22.04.20	08.30	98 /	
1174695940	Egzoni	Haxhiqaj	045387303	latoq - Kovragje	Ndërtimi i fermës për brojer	06/160	5.00	Copë	29916.00	26.04.20	08.00	98 /	
1004388468	Basim	Armetaj	044668845	Skenderaj - Pizalle	Ndërtimi i shtalles për trashjen e vizarve	03	17.00	Copë	100090.00	29.04.20	10.00	98 / 88 /	
1001261521	Eduard	Makaj		Gjakovë - Fshaj	Ndërtimi i fermës për magjmet e vizarve përmet		4.00	Copë	57850.00	29.04.20	14.41	98 / 78 /	
1172389038	Arben	Musliu	044754582	Skenderaj - Lëroc	Ndërtimi i shtalles për viza		5	12.00	Copë	35912.00	29.04.20	14.59	98 /
1170351220	Jakup	Gashi	400283	Malaheve - Mëçan	Ndërtimi i shtalles për magjmet		1.00	Pa Përc.	39713.30	12.06.20	10.00	98 /	
1003270030	Ish	Celca	044/225/436	Kaçanak - Glibogoc	Ngritja e Shtalles	02/2013	1.00	Copë	34730.00	11.03.20	08.55	96 /	
1016104023	Bedri	Buzaj	04528472	Malaheve - Lladroc	Projekti për magjmet e vizarve		12.00	Copë	46052.00	14.03.20	10.45	96 /	
1005318509	Hasan	Jashari	044/195/235	Skenderaj - Prizak i poshtem	Ndërtimi i shtalles së re për viza infrastrukturë	ska	8.00	Copë	122480.00	20.03.20	10.00	96 / 96 /	
1003333770	Feriz	

Printo Listën Shfaq Erroren

Figura 38. Softuerin për menaxhimin e granteve që shfrytëzohet nga zyrtarët e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë – AZHB

Autorizimi i Pagesave: në vitin 2014 është zhvilluar moduli i Autorizimit të Pagesave ku kërkesat për pagesë plotësohen në zyret regjionale të AZHB-së, kalkulimi dhe autorizimi i pagesave bëhet nga zyrtarët e Autorizimit të Pagesave, ku bëhet kalkulimi i fakturave dhe përpilimi i listave për kontrollë në terren dhe përgatitja e listës për pagesë.



Republika e Kosovës
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë

Projektit e Zhvillimit Rural të Kosovës

Administrimi Definicionet Miratimi Raportet Autorizimi i Pagesave Zyrtarë Regionale

Lista e Aplikimeve për Pagesë nga Zyrtarë Regionale

Vite: 2014 Masa: MASA 101 Investimet në asetet ftoke në ekonomitë bujqësore

Regioni: Te gjitha Regionet Nën-Masa: Sektori i pemëve - 2014

Kërkjo

Nr Personal	Emri	Mbiemri	Nr Femert	Telefoni	Komuna	Vendi	Emri i Projektit	Nr i aplikacionit	Vlera e projektit	Vlera e miratuar	Ndihma publike	% pranuar
1011370946	IL SH HIBUD	SHKURTA	1004558	044 105 020	Ferizaj		Ngjitja e pemë	25 040	79,216.00	69,810.00	48867.00	70
1170281638	Raf	Lushitaku	1003973	044 161 455	Skenderaj		Zgjerimi me si...	21 65	87,620.00	79,750.00	59812.50	75
1015262545	Mehdi	Bresalla	1006657	044119-471	Drenas		Mbulimi i pemë...	19 79	60,696.00	60,696.00	36417.60	60
1005715918	Ramiz	Lestran	1023002	044 140 711	Drenas	Bace	Ngjitja e pemë...	19 111	40,179.00	16,168.00	10599.20	65
1001059943	Ann Group	Kapku	1030037		Prahinë	Prahinë	Ngjitja e pemë...	19 102	100,360.00	98,950.00	59370.00	60
1019691175	Kodra E Dësh...	Nura Duraku	1028333	044500942	Prahinë	Prahinë	Investime ne ...	19 083	108,900.00	93,770.00	65639.00	70
1500678603	Riutem	Vuhaj	1015780	4 546-007	Itiq	Velle	Ngjitja e pemë...	06 117	56,810.00	56,810.00	34086.00	60
1200480315	Drenahë	Thaçi	1030055	044 213095	Prahinë	Prahinë	Investime ne ...	19 141	94,950.00	76,026.00	49416.90	65
1002531484	Futex Sh.P.K.	Pajuh	1030145	044 119 925	Suharekë	Suharekë	Ngjitja e pemë...	24 179	106,515.00	98,115.00	58869.00	60

Prano Aplikacionin

Totale: 9

Figura 39. Softuerin për autorizimin e pagesave që shfrytëzohet nga zyrtarët e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë – AZHB

Web faqja

Mirëmbajtja e web faqës së Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB) bëhet nga Divizioni i IT dhe Regjistrave. Gjatë vitit 2014 janë publikuar të gjitha thirrjet për aplikim për Grante dhe Subvencione, formularët për aplikim, listat e përfituesve të granteve dhe subvencioneve, udhëzuesit për aplikues, udhëzimet administrative, si dhe materiale të ndryshme informuese të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB). Publikimi i këtyre informatave është bërë në gjuhën shqipe dhe serbe.



Figura 40. Web faqja e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë – AZHB



Softueri për Indikator

Ka filluar të plotësohet me të dhëna nga Divizioni i Projekteve të Zhvillimit Rural pas përzgjedhjes së përfituesve. Gjatë vitit 2014 janë importuar të gjitha aplikacionet e regjistruara në Grant Menaxhment, në vitet në vazhdim ky proces për importimin e të dhënave nuk është i nevojshëm pasi që Softueri për Indikator dhe Grant Menaxhmenti janë të ndërlidhur në mes veti dhe është bërë harmonizimi i të gjitha tabelave ku bëhet shkëmbimi automatik i të dhënave. Avancimi i mëtutjeshëm i Softuerit për Indikator është mbështetur nga projekti DANIDA i financuar nga Qeveria e Danimarkës.



Republika e Kosovës
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë



Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë
dhe Zhvillimit Rural
Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural

MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK
DANIDA INTERNATIONAL DEVELOPMENT COOPERATION



Funded and implemented by TAMAD Project for MAFRD/Financuar dhe implementuar nga Projekti i TAMAD-it per MPEZHR

Treguesit Raportim i avancuar Graphical reports Administrimi Ndhimë eFR Ç'kçem

Selekto gjuhën Shqip

Treguesit

Tabela: Project Indicators

Kërko

Nr.	Viti	Masa	Nën masa	Komuna	Grumbullimi i indikatorëve për projektin (*)	Perfituesi (*)	NIF (*)	Vlera totale e ndihmës publike	Selektimi i tekstit të prodhimit 1	Prodhimi 1	Fillestar	Të rinj	Femra	Totali i vlerës ekstra të prodhimit bujqësor në (euro/vit)	Numri i përgjithshëm i vendeve të reja të punës ekuivalente me vende të punës me orar të plotë	Të pranuar	Të zgjedhura	Të finalizuar				
69	2013	2	Frutat – molla dhe frutat e imta	Gjilan	Pemisimi i infrastrukures	Blerim Shehku	1010116	12860	Vëllimi i përgjithshëm i investimit në (euro)	19831	Po	Jo	Jo	1100	2	Të pranueshme	Të zgjedhura	Jo				
59	2013	2	Vezët	Gjakovë	Pemisimi i teknologjise ne ferme dhe mekanizim	NPSH Rraki Farm Rrahman Kida	1013339	38200	Vëllimi i përgjithshëm i investimit në (euro)	58769	Jo	Po	Jo	6000	2	Të pranueshme	Të zgjedhura	Jo				
86	2013	2	Frutat – molla dhe frutat e imta	Ferizaj	Ngritja e pemishtes me molla	Naim Hasani	1024678	39000	Vëllimi i përgjithshëm i investimit në (euro)	60750	Po	Jo	Jo	1000	2	Të pranueshme	Të zgjedhura	Jo				
71	2013	2	Frutat – molla dhe frutat e imta	Ferizaj	Infrastruktura ne pemishte dhe mekanizim	Enver Zhinipotoku	1003868	3300	Vëllimi i përgjithshëm i investimit në (euro)	5076	Po	Jo	Jo	3695	1	Të pranueshme	Të zgjedhura	Jo				
104	2013	2	Frutat e malit	Malishevë	Fruta Mali-Bime Mjekuese	Shefqet Krasniqi	1025838	11063	Vëllimi i përgjithshëm i investimit në (euro)	19912	Po	Jo	Jo	950	4	Të pranueshme	Të zgjedhura	Jo				
57	2013	2	Vezët	Rahovec	Ndertimi i shtalles se re me kapacitet 3600 pula vojse	NTP Agro Labi Selami Zllanoga	1009846	32825	Vëllimi i përgjithshëm i investimit në (euro)	50500	Jo	Jo	Jo	5000	3	Të pranueshme	Të zgjedhura	Jo				
67	2013	2	Frutat – molla dhe frutat e imta	Kamenicë	Ngritja e pemishtes me infrastrukture dhe mekanizim	Shkelzen Mehmeti	1017506	92553	Vëllimi i përgjithshëm i investimit në (euro)	142390	Po	Jo	Jo	3000	2.45	Të pranueshme	Të zgjedhura	Jo				
82	2013	2	Frutat – molla dhe frutat e imta	Skënderaj	Ngritja e pemishtes me molla	Hekuran Latifaj	1022090	11700	Vëllimi i përgjithshëm i investimit në (euro)	18000	Po	Po	Jo	1000	3.37	Të pranueshme	Të zgjedhura	Jo				
55	2013	2	Vezët	Prizren	Zgjerimi i kapacitetit per pula vojse	DPT Civilen Farm	1014303	19497	Vëllimi i përgjithshëm i investimit në (euro)	29996	Jo	Jo	Po	3000	2	Të pranueshme	Të zgjedhura	Jo				
61	2013	2	Vezët	Podujevë	Ndertimi i shtalles se pulave vojse	Blerim Blakçori	1013602	26000	Vëllimi i përgjithshëm i investimit në (euro)	115000	Jo	Po	Jo	2000	1.5	Të pranueshme	Të zgjedhura	Jo				
90	2013	2	Frutat – molla dhe frutat e imta	Lipjan	Ngritja e pemishtes me molla	Mehdi Bresilla	1006657	20948	Vëllimi i përgjithshëm i investimit në (euro)	32228	Jo	Jo	Jo	1600	2	Të pranueshme	Të zgjedhura	Jo				
63	2013	2	Vezët	Drenas	Infrastruktura ne fermen e pulave	Izjah Qelaj	1024420	62104	Vëllimi i përgjithshëm i investimit në (euro)	95545	Jo	Jo	Jo	1000	3	Të pranueshme	Të zgjedhura	Jo				
80	2013	2	Frutat – molla dhe frutat e imta	Vushtri	Pemishte me infrastrukture	Sead Haradinaj	1024483	39000	Vëllimi i përgjithshëm i investimit në (euro)	77033	Po	Po	Jo	1600	5	Të pranueshme	Të zgjedhura	Jo				
84	2013	2	Frutat – molla dhe frutat e imta	Drenas	Ngritja e pemishtes se re me molla	Ramadan Hoxha	1000633	28470	Vëllimi i përgjithshëm i investimit në (euro)	47558	Po	Jo	Jo	2000	3	Të pranueshme	Të zgjedhura	Jo				
65	2013	2	Frutat – molla dhe frutat e imta	Istog	Ngritja e pemishtes me molla dhe infrastrukture komplet ne sip prej zha dhe mekanizim	Eflet Sylaj	1023311	19790	Vëllimi i përgjithshëm i investimit në (euro)	33037	Po	Po	Po	2000	3	Të pranueshme	Të zgjedhura	Jo				
78	2013	2	Frutat – molla dhe frutat e imta	Istog	Ngritja e pemishtes me molla dhe infrastrukture	Ilirida Shoshi	1023355	21750	Vëllimi i përgjithshëm i investimit në (euro)	36052	Jo	Po	Po	3000	3	Të pranueshme	Të zgjedhura	Jo				
73	2013	2	Frutat – molla dhe frutat e imta	Skënderaj	Ngritja dhe infrastrukture ne pemishte	Xhelal Krasniqi	1025900	38978	Vëllimi i përgjithshëm i investimit në (euro)	59967	Po	Jo	Jo	5000	3	Të pranueshme	Të zgjedhura	Jo				
77	2013	2	Frutat – molla dhe frutat e imta	Pejë	Ngritja e pemishtes se re	Fatos Kelmendi	1021602	31200	Vëllimi i përgjithshëm i investimit në (euro)	48000	Po	Jo	Jo	2200	2	Të pranueshme	Të zgjedhura	Jo				
87	2013	2	Frutat – molla dhe frutat e imta	Skënderaj	Ngritja e pemishtes me sistem mbrojtës kunder breshërit-molla	Mihane Rama	1023373	54000	Vëllimi i përgjithshëm i investimit në (euro)	91323	Po	Po	Jo	2000	2	Të pranueshme	Të zgjedhura	Jo				
56	2013	2	Vezët	Gjakovë	Ndertimi i fermes me paisje per 3600 pula	NTP Vlodi Farm Ismet Kida	1023847	26000	Vëllimi i përgjithshëm i investimit në (euro)	40000	Po	Po	Jo	4000	2	Të pranueshme	Të zgjedhura	Jo				

Figura 41. Softuerin për indikator i cili funksionon në tri gjuhë: shqip, anglisht dhe serbisht



Numri i të punësuarve të ri sipas Nen-Masave		
Masa	Nen-Masa	Nr. Punëtorve
MASA 302- Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve	NENMASA 302.1 - Bletaria dhe prodhimi/përpunimi dhe tregtimi i mjaltit	127
MASA 302- Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve	NENMASA 302.2 - Përpunimi i barishteve, bimëve mjekuese, frutave pyjore dhe kërpudhave të grumbulluara	8
MASA 302- Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve	NENMASA 302.3 - Përpunimi në fermë dhe tregtimi i prodhimeve bujqësore në shkallë të ulët (perimet, fruta, barishte, erëza, bimë mjekuese, kërpudhat, si dhe qumështi i deleve dhe dhive)	5
MASA 103 - Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore	Përpunimi i mishit - 2014	104.2
MASA 103 - Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore	Përpunimi i pemëve dhe perimeve - 2014	186
MASA 103 - Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore	Përpunimi i qumështit - 2014	40
MASA 103 - Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore	Prodhimi i verës - 2014	53
MASA 101: Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore	Sektori i drithërave - 2014	31.2
MASA 101: Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore	Sektori i mishit (brojleret) - 2014	25
MASA 101: Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore	Sektori i mishit (trashja e viçave) - 2014	83.55
MASA 101: Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore	Sektori i pemëve - 2014	77.1
MASA 101: Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore	Sektori i perimeve në fushë të hapur (përfshirë patatet) - 2014	45.7
MASA 101: Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore	Sektori i perimeve serra - 2014	129.91
MASA 101: Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore	Sektori i qumështit - 2014	117.22
MASA 101: Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore	Sektori i rrushit - 2014	39.3
MASA 101: Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore	Sektori i vezëve - 2014	33
MASA 101: Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore	Sektori për pemë të imeta (dredhëz, mjedërr dhe manaferrë) - 2014	50.82
Total		1156.00

Tabela 47. Numri i të punësuarve të ri sipas Nen-Masave



Republika e Kosovës
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë

Numri i Miratuar / Kontraktuar sipas Nen-Masave		
Masa	Nen-Masa	Nr i Miratuar / Kontraktuar
MASA 302- Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve	NENMASA 302.1 - Bletaria dhe prodhimi/përpunimi dhe tregtimi i mjaltit	56
MASA 302- Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve	NENMASA 302.2 - Përpunimi i barishteve, bimëve mjekuese, frutave pyjore dhe kërpudhave të grumbulluara	2
MASA 302- Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve	NENMASA 302.3 - Përpunimi në fermë dhe tregtimi i prodhimeve bujqësore në shkallë të ulët (perimet, fruta, barishte, erëza, bimë mjekuese, kërpudhat, si dhe qumështi i deleve dhe dhive)	1
MASA 103 - Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore	Përpunimi i mishit - 2014	8
MASA 103 - Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore	Përpunimi i pemëve dhe perimeve - 2014	9
MASA 103 - Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore	Përpunimi i qumështit - 2014	8
MASA 103 - Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore	Prodhimi i verës - 2014	4
MASA 101: Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore	Sektori i drithërave - 2014	14
MASA 101: Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore	Sektori i mishit (brojleret) - 2014	11
MASA 101: Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore	Sektori i mishit (trashja e viçave) - 2014	33
MASA 101: Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore	Sektori i pemëve - 2014	24
MASA 101: Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore	Sektori i perimeve në fushë të hapur (perfshirë patatet) - 2014	20
MASA 101: Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore	Sektori i perimeve serra - 2014	48
MASA 101: Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore	Sektori i qumështit - 2014	47
MASA 101: Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore	Sektori i rrushit - 2014	19
MASA 101: Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore	Sektori i vezëve - 2014	11
MASA 101: Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore	Sektori për pemë të imeta (dredhëz, mjedërr dhe manaferrë) - 2014	16
Ujitja	Ujitja e tokave bujqësore	6
Total		337

Tabela 48. Numri i Miratuar / Kontraktuar sipas Nen-Masave



Mirëmbajtja e rrjetit të internetit për Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë – AZHB

Mirëmbajtja bëhet nga Divizioni i IT dhe Regjistrave dhe vetëm përbrenda Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë.

Më poshtë mund të shihni skemën e komunikimit të rrjetit të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë dhe Ministrisë së Administratës Publike, si dhe komunikimi i databazave të AZHB-së që janë të hostuara në dhomat e serverve në Ministrinë e Administratës Publike:




Figura 42. Skema e IT-së AZHB - MAP

